

BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E MEDIAS DHE KOMUNIKIMIT ME QYTETARËT
DREJTORIA E KOMUNIKIMIT ME QYTETARËT
SEKTORI I KONSULTIMIT PUBLIK DHE OPINIONEVE QYTETARE

Raport sondazhi

Përvojat dhe pritshmëritë për qendrën TUMO Tirana



Mars 2025

Përmbajtja

Rreth sondazhit	3
Demografia	3
Rezultate	6
Rekomandime	12
Aneks II – Pyetësi i sondazhit	13

Rreth sondazhit

TUMO Tirana është e para qendër për teknologji kreative në Shqipëri dhe një qendër pas shkolle për fëmijë të grupmoshës 12-18 vjeç të cilët do të kenë mundësinë të zbulojnë pasionin e tyre në 8 disiplina të ndryshme si Animation, Graphic Design, Game Development, Film Making, Music, Programming, Robotics, 3D Modelling.

Në TUMO Tirana, fëmijët do të zhvillojnë planin e tyre mësimor të personalizuar nëpërmjet një platforme virtuale të quajtur TUMO Path, e cila është krijuar për t'ju përshtatur kurrikulës së shumëllojshme. Kurrikula mundëson krijimin e planeve të personalizuar të të mësuarit në mënyrë të pavarur, nën supervizion të ekspertëve dhe mentorëve. Plani mësimor ofron zhvillimin e ëorkshop-eve dhe laboratorëve ku nxënësit thellojnë dijet dhe aftësitë e tyre në një temë zgjedhur prej tyre, punojnë në grup dhe krijojnë portofolot e tyre në formën e projekteve në modelim 3D, programim kompjuterik, robotikë, muzikë, etj.

Njohuritë që fëmijët fitojnë nëpërmjet kurseve dhe kurrikulave i ndihmojnë në zhvillimin e krijimtarisë dhe të menduarit analitik. Gjatë ëorkshop çdo nxënës ka një tutor roli i të cilit është të ndjekë pjesëmarrjen e fëmijës, ta inkurajojë në rritje të performancës dhe ta orientojë gjatë procesit të eksplorimit të informacionit dhe krijimtarisë së fëmijës.

Duke qenë një program pas-shkollor, TUMO ofron një eksperiencë unike mësimore, e cila ndërthur teknologjinë dhe dizajnin. TUMOianët nga mosha 12 deri në 18 vjeç do të kenë mundësinë të zgjedhin vetë rrugëtimin e tyre mësimor duke përfutur aftësi në disa nga fushat më novatore të shekullit të 21-të. Nëpërmjet një sërë aktiviteteve, të mësuarit në mënyrë të pavarur, ëorkshop-eve bashkëvepruese

Qëllimi i sondazhit është të evidentojë opinionet e të rinjve për përvojën dhe pritshmëritë për qendrën TUMO Tirana.

Objektivat e sondazhit:


- a) Vlerësimi për përvojën në qendrën TUMO dhe si merret informacioni;
- b) Fushat me më shumë interes dhe përshtatshmëria me programet;
- c) Sugjerime për përmirësime në qendrën TUMO;
- d) Vlerësimi për kurset falas dhe rekomandimi tek të tjerët;
- e) Komentë të hapura.

Sondazhi u zhvillua gjatë periudhës 10 – 25 mars 2025 dhe u anketuan nxënës të shkollave publike të kryeqytetit. Anketimi u krye nëpërmjet intervistave ballë për ballë me të rinj që përfitojnë kurse pranë qendrës TUMO Tirana ku u plotësuan 300 pyetësorë¹, si edhe online në faqen zyrtare të internetit <https://tirana.al/faqe/sondazhe>, duke e shpërndarë në rrjetet sociale instagram dhe facebook të Sektorit të Konsultimit Publik dhe Opinioneve Qytetare.

¹ Aneks II – Pyetësori i sondazhit

Demografia


Në këtë grafik paraqitet shpërndarja e nxënësve të qendrës TUMO Tirana, ku Njësia Administrative Nr. 5 ka përqindjen më të lartë (18%), e ndjekur nga Njësia Administrative Nr. 2 me 12%, ndërsa njësitë administrative nr: 1, 3, 8, 10 me 8% secila etj. (Grafiku nr.1).



Të anketuarit për këtë sondazh janë 55% meshkuj dhe 45% femra (Grafiku nr.2).



Anketimi është zhvilluar me të nxënës të moshave 10 – 18 vjeç², ku më e përfaqësuar është mosha 15 vjeç me 24%, e ndjekur nga mosha 14 vjeç me 22%, ndërsa moshat 12, 13 dhe 16 vjeç kanë një pjesëmarrje të ngjashme 15 – 16%. Mosha 17 vjeç ka një pjesëmarrje 5% etj. (Grafiku nr.3).




² Tre të rinj 10-vjeçarë kanë marrë pjesë në sondazh

Frekuentuesit e qendrës TUMO Tirana janë *nxënës të shkollave të kryeqytetit*, ku shkolla me përfaqësimin më të lartë është shkolla “Edit Durham” me 12%, shkolla “Ismail Qemali” me 9%; shkollat “Gjergji Canco” dhe “Besnik Sykja” me 8% secila.


Shkollat me një përqindje të balancuar janë: “Kosova” dhe “Emin Duraku” me 7%; shkollat: “Ali Demi”, “E kuqe”, “Dora Distria” dhe “Dëshmorët e Lirise” me 5% secila.

Shkollat me përqindjen më të ulët janë: “Partizani”, “Lekë Gjikuria” dhe “Konferenca Pezës” me 1% secila (Grafiku nr.4).




Rezultate


Të pyetur mbi përvojën në qendrën TUMO Tirana, 83% e të anketuarve kanë *vlerësim shumë të mirë*, 11% kanë vlerësim të mirë, ndërsa 6% kanë vlerësim disi të mirë (*Grafiku nr.5*).




Sa i përket pyetjes “Cila është mënyra më e zakonshme që përdorni për të marrë informacion për kurset?”, rezulton se rrjetet sociale janë *burimi kryesor i informacionit për kurset që zhvillohen tek TUMO Tirana* (61%), 34% janë informuar nga miqtë apo familjarë, 29% nga faqja zyrtare e TUMO Tirana, 11% janë informuara shkolla ose universiteti etj. (*Grafiku nr.6*).




51% e të rinjve të anketuar paraqesin *interes për të zhvilluar aftësitë* në programim, 43% në grafik dizajn, 35% në inteligjencë artificiale, 29% në animacion 2D dhe 3D, 23 – 26% janë të interesuar për robotikë dhe kinematografi/video montazh, ndërsa 23% mendojnë të zhvillojnë aftësitë e tyre në muzikë digjitale (Grafiku nr.7).




59% e të rinjve të anketuar janë shprehur se ndihen shumë të përgatitur për të ardhmen falë aftësive të fituara në qendrën TUMO Tirana, 34% ndihen disi të përgatitur etj. (Grafiku nr.8).




Programet që ofrohen janë ndërtuar për të qenë të përshtatshme me moshën dhe interesat e të rinjve. 81% e të anketuarve janë plotësisht të kënaqur me programet, 14% pjesërisht të kënaqur, ndërsa 6% janë jo shumë dhe aspak të kënaqur (Grafiku nr.9).




Të pyetur për përmirësimet që do t'a bënin përvojën në TUMO Tirana më të mirë, 40% janë shprehur se kërkojnë më shumë kurse të avancuara dhe më shumë mundësi bashkëpunimi me profesionistë, 37% kërkojnë më shumë projekte praktike, 26% shtim të eventeve dhe garave të ndryshme, 12% shtim të më shumë pajisjeve të reja dhe teknologjisë (Grafiku nr.10)



45% e nxënësve të anketuar janë shumë të kënaqur që kurset në TUMO Tirana ofrohen falas, 33% janë të kënaqur, 19% mesatarisht të kënaqur etj. (Grafiku nr.11).



82% e të rinjve janë të predispozuar për t'a rekomanduar qendrën TUMO edhe tek miqtë e tyre, 14% janë shprehur se ndoshta do t'a rekomandonin, ndërsa 4% janë shprehur se nuk e rekomandojnë (Grafiku nr.12).



Rekomandime

- Të ketë zgjerim të ambienteve
- Më shumë pajisje teknologjike
- Pajisje me certifikatë për kryerjen e kurseve pranë qendrës TUMO Tirana
- Zhvillimi i sa më shumë ëorkshope – ve për njohuri të reja digjitale

Aneks I – Pyetësi i sondazhit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E MEDIAS DHE KOMUNIKIMIT ME QYTETARËT
DREJTORIA E KOMUNIKIMIT ME QYTETARËT
SEKTORI I KONSULTIMIT PUBLIK DHE OPINIONEVE QYTETARE

Nr. i pyetësit _____

Tiranë, më ____/____/2025

Pyetësor – TUMO Tirana

<i>Nj.Administrative/Lagje</i>	<i>Gjinia</i>		<i>Mosha</i>	<i>Shkolla/Universiteti</i>
	F	M		

1. Si e vlerësoni përvojën tuaj në TUMO Tirana?

(TUMO është një qendër për të rinjtë si edhe një përvojë e re edukative në kryqëzimin e teknologjisë dhe dizajnit)

- ☐ Shum të mirë
☐ Të mirë
☐ Disi të mirë

2. Cila është mënyra më e zakonshme që përdorni për të marrë informacion për kurset?

(Mund të zgjidhni më shumë se një mundësi)

- ☐ Rrjetet sociale
☐ Faqja zyrtare e TUMO Tirana
☐ Miq/familjarë
☐ Shkolla/Universiteti
☐ Të tjera (specifikoni): _____

3. Në cilat fusha keni më shumë interes për të zhvilluar aftësitë tuaja?

(Mund të zgjidhni më shumë se një mundësi)

- ☐ Programim
☐ Inteligjencë Artificiale
☐ Grafik dizajn
☐ Animacion 2D/3D
☐ Video montazh / Kinematografi
☐ Robotikë
☐ Muzikë digjitale

☐ Të tjera (specifikoni): _____

4. A ndiheni më të përgatitur për të ardhmen falë aftësive të fituara në TUMO?

- ☐ Po, shumë
☐ Disi
☐ Jo shumë
☐ Aspak

5. A mendoni se programet janë të përshtatshme për moshën dhe interesat tuaja?

- ☐ Po, plotësisht
☐ Pjesërisht
☐ Jo shumë
☐ Aspak

6. Cila nga këto përmirësime do ta bënte përvojën tuaj në TUMO më të mirë?

(Mund të zgjidhni më shumë se një mundësi)

- ☐ Më shumë kurse të avancuara
☐ Më shumë projekte praktike
☐ Më shumë evente dhe gara
☐ Më shumë mundësi bashkëpunimi me profesionistë
☐ Më shumë teknologji dhe pajisje të reja
☐ Të tjera (specifikoni): _____

7. Sa të kënaqur jeni që kurset në TUMO Tirana ofrohen falas?

Aspak të kënaqur – 1 2 3 4 5 – Shumë të kënaqur

8. A do ta rekomandonit TUMO-n te miqtë tuaj?

- ☐ Po, patjetër
☐ Ndoshta
☐ Jo

9. A keni ndonjë sugjerim apo koment për përmirësimin e qendrës TUMO?

(Pyetje e hapur)

Shënim: Ky pyetësor organizohet nga Bashkia e Tiranës dhe ka për qëllim të evidentojë opinionet për përvojën dhe pritshmëritë e të rinjve për TUMO Tirana.

Ju sigurojmë që të dhënat tuaja janë për qëllim studimi dhe në përputhje me Ligjin nr 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; Ligjin 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”; Ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”; Ligjin nr. 120/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar”.

Ju falënderojmë për kohën që i kushtuat plotësisht të këtij pyetësori dhe për mendimet që ndatë me ne, me vlerë për përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve të Tiranës.